

V E N D I M
Nr. 505, datë 14.8.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave:

a) Në pikën 3 të shtohen:

“-Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

-Bashkëshorti/bashkëshortja e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit”.

b) Në pikën 4 të shtohet:

“-Sekretari i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
ILIR META